



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51 regjistër (JR)  
Datë 23.11.2020

Nr. 7 i vendimit  
Datë 23.02.2021

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 23.02.2021, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 51/2020 (JR), datë 23.11.2020, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Alaudin Malaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 294, datë 15.09.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Alaudin Malaj.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet F dhe G të Aneksit të Kushtetutës; vendimi nr. 78/2018 i Gjykatës Kushtetuese.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në prani të ankuesit (përveç seancës së datës 23.02.2021 në të cilën ai nuk u paraqit), në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit

nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Alaudin Malaj, në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar nga Komisioni, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Për shkak të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Alaudin Malaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në datën 30.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) i ka përcjellë Komisionit vendimin e tij nr. 265, datë 30.07.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Alaudin Malaj”, me anë të të cilit ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Alaudin Malaj, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status, me efekt nga data 31.07.2020.
3. Në rrethanat e mësipërme, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ndërpreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Alaudin Malaj, me vendimin nr. 294, datë 15.09.2020.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 294, datë 15.09.2020, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, vendosi:
  1. *Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Alaudin Malaj, është ndërprerë.*
  2. *Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.*

[...]

### III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit Alaudin Malaj, më datë 06.10.2020, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, duke pretenduar se ky vendim është plotësisht i pabazuar në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet të priset. Subjekti sqaroi në ankimin e ushtruar prej tij se në kushtet kur ai tashmë është dorëhequr nga funksioni i gjyqtarit, konstatimi i shkeljeve ligjore nga Komisioni nuk i shërben në thelb hetimit të kryer, por ka për qëllim konstatimin e njëanshmërisë së theksuar të trupit gjykues të Komisionit, si dhe konstatimin e paligjshmërisë së shprehjes së tij me një vendimmarje, ndërkohë që ishte në kushtet e konfliktit të hapur të interesit.

6. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me vendimin e Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, kundërshtoi nëpërmjet ankimit të tij edhe vendimin e ndërmjetëm të Komisionit, datë 15.04.2020, me anë të të cilit është rrëzuar kërkesa e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres E. Ç..
7. Subjekti i rivlerësimit Alaudin Malaj kërkoi përfundimisht nga Kolegji që, pas shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankimin e tij, të vendosë:
  - *Prishjen e vendimit nr. 294, datë 15.09.2020, të Komisionit si një vendim që është rrjedhojë e cenimit të parimit të paanësisë në mënyrën e formimit dhe përbërjen e trupit gjykues.*
  - *Prishjen e vendimit të datës 15.04.2020 të Komisionit për rrëzimin e kërkesës për përjashtim, duke vendosur: Pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe përjashtimin e komisioneres E. Ç. nga përbërja e trupit gjykues.*
  - *Dërgimin e çështjes së rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Alaudin Malaj pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për t'u gjykuar nga një trup tjetër gjykues.*
  - *Në të kundërt, prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të mosqenies më subjekt i shqyrtimit në fazën aktuale të gjykimit të çështjes.*
8. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

**8.1 Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision,** subjekti pretendoi se janë kryer shkelje të rënda procedurale nga ana e trupit gjykues të çështjes në drejtim (i) të përbërjes së trupit gjykues dhe (ii) të kryerjes së procedurës së hetimit administrativ. Subjekti pretendoi se, si pasojë e këtyre shkeljeve procedurale, atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe për gjykimin e çështjes nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur e caktuar me ligj, në shkelje të neneve 42 dhe 179/b të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, neneve 4, pika 5 dhe 27 të ligjit nr. 84/2016.

**8.2 Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vendimin e ndërmjetëm të Komisionit të datës 15.04.2020,** për mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres E. Ç., pasi sipas tij, trupi gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e tij, ka parashtruar në vendim disa fakte të pavërteta, si dhe se subjektit të rivlerësimit nuk i është vënë në dispozicion një kopje e njësuar e praktikës së ndjekur nga Komisioni për këtë vendimmarrje.

**8.3 Subjekti i rivlerësimit pretendoi se çështja e tij,** pasi të pranohet ankimi nga Kolegji dhe të vendoset prishja e vendimit të Komisionit, duhet të shqyrtohet nga një tjetër trup gjykues i Komisionit dhe jo nga Kolegji, duke qenë se, sipas tij, neni F i Aneksit të Kushtetutës nuk mund të gjejë aplikim në rastin objekt ankimi, kur kjo dispozitë u referohet shkeljeve procedurale dhe vendimmarrjes finale të Komisionit, në rastet kur ky i fundit është shprehur në themel për konfirmimin ose shkarkimin e një subjekti.

9. Gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit paraqiti para Kolegjit Smarrjen e provës me dëshmitarë; (iii) kallëzimin pranë organit kompetent për marrjen dijeni gjatë ushtrimit të detyrës për konsumimin e veprës penale; (iv) përjashtimin e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së; (v) pezullimin e gjykimit të çështjes me qëllim që subjekti të kërkojë nga ONM-ja përjashtimin e vëzhguesit ndërkombëtar; (vi) pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e një kërkesë Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur lidhur me kushtetutshmërinë e parashikimeve ligjore në

drejtim të mundësisë ligjore të subjekteve të rivlerësimit për të kërkuar përjashtimin nga procesi të vëzhguesit ndërkombëtar; si dhe (vii) përjashtimin nga gjykimi i çështjes së anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit që ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Alaudin Malaj, i cili nëpërmjet ankimit kërkon prishjen e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>1</sup>, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
12. Sa i takon kundërshtimit të vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të datës 15.04.2020, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 30-32 dhe 130, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative, nuk legjitimohet në ankimimin veçmas të këtij veprimi procedural të Komisionit. Për rrjedhojë, kundërshtimi i vendimit të Komisionit lidhur me rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres E. Ç. mund të kryhet vetëm në kuadër të kundërshtimit

---

<sup>1</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, për rivlerësimin e subjektit Alaudin Malaj i është njoftuar subjektit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.09.2020, në adresën postare: rruga "{\*\*\*}" nr. {\*\*\*}, H. {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, Njësia Administrative Nr. {\*\*\*}, Tiranë, njoftim i cili është kthyer pasi adresa rezultoi në lajmërimmarje "i larguar". Në vijim Komisioni, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 21.09.2020, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit vendimin e tij nr. 294, datë 15.09.2020 dhe në datë 25.09.2020, në kushtet që nuk ka marrë konfirmim nga ana e subjektit të rivlerësimit, ka proceduar me njoftim për shpallje me afishim të vendimit të Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, njoftim i cili rezultoi të jetë afishuar në këndin e njoftimeve të Njësies Administrative Nr. {\*\*\*}, më datë 28.09.2020. Ndërkohë ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë shërbimit postar në adresë të Komisionit më datë 06.10.2020, dhe është protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.10.2020. Në këto kushte subjekti rezultoi të ketë ushtruar ankim në ditën e 15-të të afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, referuar njoftimit të kryer në adresën e tij elektronike më datë 21.09.2020, në përputhje me parashikimet e nenit 46 të ligjit nr. 84/2016.

të vendimit të Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020 dhe shqyrtohet për aq sa ky veprim procedural ndikon në këtë vendimmarrje.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi, nga ku u konstatua *ex officio* se gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike duke i garantuar atij të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur para trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Trupi gjykues vendosi gjithashtu t'i kërkojë Komisionit përcjelljen pranë Kolegjit të fashikullit të plotë të krijuar në Komision gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit Alaudin Malaj.
14. Sa u takon kërkesave procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit para trupit gjykues, ato të cilat lidheshin me marrjen e disa akteve shkresore në cilësinë e provave, u pranuan prej tij, ndërsa kërkesa për marrjen e provës me dëshmitarë u rrëzua, bazuar në parashikimet e nenit 49, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 84/2016, pasi në vlerësimin e trupit gjykues, thirrja e personave të treguar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e dëshmitarëve, ishte e panevojshme në kuadër të zgjidhjes së çështjes. Ndërkohë, sa u takon kërkesave të tjera të subjektit të rivlerësimit, sipas referimit në paragrafin 9 më sipër në vendim, ato u rrëzuan nga trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm, rast pas rasti<sup>2</sup>, pasi u vlerësuan si kërkesa të pabazuara në ligj, kërkesa të cilat nuk lidhen me ankimin apo shqyrtimin e vendimit të Komisionit objekt ankimi, ose kërkesa objekti i shqyrtimit të cilave tejkalonte kompetencat vendimmarrëse të Kolegjit.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit*

15. Në kuadër të shkakut të ankimit për shkelje të rregullave procedurale me pasojë cenimin e së drejtës për proces të rregullt, subjekti i rivlerësimit i fokusoi pretendimet e tij në drejtim (i) të përbërjes së trupit gjykues të Komisionit dhe (ii) të kryerjes prej këtij të fundit të procedurës së hetimit administrativ. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues vëren si vijon.

*(i) Në drejtim të përbërjes së trupit gjykues të Komisionit*

16. Lidhur me zëvendësimin e komisioneres G. T. (B.), e cila është shortuar fillimisht si anëtare e trupit gjykues së bashku me komisioneret E. Ç. dhe S. Zh., subjekti i rivlerësimit pretendoi se arsyet e dorëheqjes së kësaj komisionereje nuk i janë bërë të ditura, pavarësisht kërkesës për informacion në këtë drejtim. Gjithashtu, subjekti pretendoi se anëtarët e trupit gjykues kanë vijuar me procedurat e hetimit administrativ, pa pritur të shprehet subjekti i rivlerësimit lidhur me kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

<sup>2</sup> Shih procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 11.01.2021, 27.01.2021 dhe 17.02.2021.

17. Në lidhje me komisioneren S. Zh., subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo komisionere gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, duke qenë se në ngarkim të bashkëshortit të saj është regjistruar një çështje gjyqësore penale pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 10.10.2017, e cila sipas subjektit të rivlerësimit ishte shortuar për t'u gjykuar prej tij në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Subjekti pretendoi se komisionerja S. Zh. nuk ka marrë masat për të shmangur konfliktin e interesit me subjektin e rivlerësimit në këtë rast.

18. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi edhe se në përbërje të trupave gjykuese të cilat kanë shqyrtuar kërkesat për heqje dorë dhe/apo përjashtim të komisionerëve O. K. dhe L. H. nga shqyrtimi i çështjes së rivlerësimit të subjektit Alaudin Malaj, ka qenë edhe komisionerja F. Sh., për të cilën subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, si pasojë e lidhjes familjare që ka me të, e cila sipas pohimit të subjektit gjatë gjykimit<sup>3</sup>, pretendohet të jetë “kushërirë e parë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, vajza e xhaxhait”.

*(ii) Në drejtim të kryerjes së procedurës së hetimit administrativ;*

19. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se trupi gjykues është treguar i njëanshëm duke qenë se nuk i ka pranuar kërkesën për zgjatje të afatit për të marrë prova, kërkesë kjo e diktuar nga gjendja shëndetësore e personit tjetër të lidhur (babait të tij), me të cilin lidheshin faktet për t'u provuar. Të njëjtin pretendim ngre subjekti edhe në drejtim të faktit të mbylljes së hetimit nga ana e trupit gjykues, pa përfunduar procesi i paraqitjes së provave nga ana e tij. Subjekti ngriti pretendime për njëanshmëri të trupit gjykues edhe pas zëvendësimit të komisionerit L. H. me komisionerin R. I., duke qenë se pas këtij momenti procedural, sipas subjektit, trupi gjykues nuk kreu asnjë procedurë hetimore lidhur me çështjen, por vijoi në mënyrë emergjente me mbylljen e hetimit administrativ dhe dërgimin e rezultatit të hetimit të përgatitur nga komisioneri paraardhës. Në përfundim, subjekti pretendoi diskriminim të rastit të tij nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes, i cili, sipas pretendimit të subjektit, në një procesverbal që i është vënë në dispozicion (të cilin e paraqiti në cilësinë e provës shkresore gjatë procesit në Kolegj) është shprehur: [...] *rrëzohani kërkesën subjektit [...]*. Subjekti shprehet për gjendje konflikti interesi për shkak të përfshirjes së vëzhguesit ndërkombëtar në këtë rast pasi, sipas tij, ai ishte dhe vëzhguesi që ndiqte çështjen në themel.

20. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi analizoi aktet e administruara në cilësinë e provave shkresore gjatë hetimit administrativ në Komision dhe ato gjatë gjykimit në Kolegj, vëren si më poshtë.

**20.1** Lidhur me pretendimet mbi zëvendësimin e komisioneres G. B., trupi gjykues konstaton se për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit Alaudin Malaj, në Komision është caktuar sipas procedurës së shortit të datës 17.09.2018, trupi gjykues me përbërje të komisionerëve E. Ç., S. Zh. dhe G. B. (T.), e cila është përzgjedhur në cilësinë e relatores së çështjes. Në vijim të kërkesës për heqje dorë të komisioneres G. B. nga shqyrtimi i çështjes së rivlerësimit për subjektin në fjalë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.09.2018, është ngritur trupi gjykues që do të merrte në

<sup>3</sup> *Shih procesverbalin e seancës gjyqësore publike të datës 27.01.2021, më konkretisht përgjigjen e subjektit lidhur me pyetjen e drejtuar nga trupi gjykues mbi saktësimin e marrëdhënies familjare mes tij dhe komisioneres F. Sh., f. 34 e procesverbalit.*

shqyrtim kërkesën e saj, i cili me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.09.2018, vendosi pranimin e kërkesës së komisioneres G. T. për heqje dorë nga procesi i rivlerësimit të subjektit Alaudin Malaj. Në pikën 3 të këtij vendimi, përcaktohet shprehimisht: *Ky vendim i njoftohet komisioneres znj. G. T., komisionerit zëvendësues z. L. H. dhe depozitohet në dosjen e subjektit të rivlerësimit Alaudin Malaj.*

**20.2** Në vendimin për pranimin e kërkesës për heqje dorë të komisioneres G. B. nga çështja e rivlerësimit të subjektit Alaudin Malaj, referohen edhe shkaqet e dorëheqjes së saj nga procesi i rivlerësimit të subjektit ankues, të cilat ky i fundit kishte mundësi t'i njihte nëpërmjet konsultimit me dosjen e krijuar në Komision, lidhur me procedurën e tij të rivlerësimit në kuadër të parashikimeve ligjore të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut ankimi për cenueshmëri të vendimit të Komisionit, si pasojë e sa më sipër pretenduar nga subjekti, për më tepër që lidhur me këtë vendimmarrje të Komisionit, nuk parashikohet asnjë mjet ligjor kundërshtimi i veçantë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**20.3** Sa i takon pretendimit lidhur me shkelje të trupit gjykues në drejtim të procedimit me hetimin administrativ të çështjes, pa prituri të shprehet subjekti i rivlerësimit lidhur me konfliktin e interesit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, konstatohet se me vendimin e trupit gjykues të Komisionit nr. {\*\*\*}, të datës 24.09.2018, është vendosur fillimi i hetimit administrativ mbi procedurën e rivlerësimit nga relatori i çështjes.

**20.4** Referuar përmbajtjes së vendimit të sipërcituar, konstatohet se pjesë e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje të parë të trupit gjykues të Komisionit ka qenë, përveç propozimit për fillimin e hetimit administrativ për procedurën e rivlerësimit, edhe deklarimi i konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues. Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, në pikën 2 të vendimit nr. {\*\*\*} të datës 24.09.2018, përcaktohet: *2. Anëtarët e trupit gjykues, znj. S. Zh. dhe znj. E. Ç. deklaruan se nuk kanë konflikt interesi me subjektin e rivlerësimit. Relatorja e çështjes znj. G. T. (B.) deklaroi se gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. [...].*

**20.5** Referuar nenit 31, pika 4 e Kodit të Procedurave Administrative, në rastet e vetëdeklarimit të pengesës ligjore dhe të rasteve të kërkesave për përjashtim, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga struktura përgjegjëse, nëpunësi (anëtari i organit kolegjal) pezullohet nga procesi vendimmarrës. Në kuptim të sa më sipër, vendimmarrja për fillimin e hetimit administrativ paraqet problematika në drejtim të përfshirjes në vendimmarrje të komisioneres G. B., e cila në të njëjtën mbledhje të trupit gjykues kishte deklaruar ekzistencën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit Alaudin Malaj. Ndërsa, sa i takon pretendimit të subjektit për shkelje në drejtim të mospritjes nga ana e trupit gjykues të shprehjes së subjektit lidhur me konfliktin e interesit, ky nuk vlerësohet si pretendim i bazuar në ligj, pasi referuar dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe atyre të Kodit të Procedurave Administrative, një detyrim i tillë nuk parashikohet. Pavarësisht sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues çmon se në çdo rast, kjo vendimmarrje e trupit gjykues, e cila karakterizohet nga parregullsi procedurale, nuk arrin të ndikojë vendimmarrjen përfundimtare të trupit gjykues të Komisionit të materializuar në vendimin nr. 294, datë 15.09.2020, lidhur me deklarimin e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për subjektin

Alaudin Malaj, për rrjedhojë, sa më sipër konstatuar në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të vlerësohet si shkak i drejtë dhe i bazuar për cenimin e vendimit të Komisionit.

**20.6** Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ekzistencë të konfliktit të interesit mes tij dhe komisioneres S. Zh., trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të administruar nga Komisioni, konstatoi se më datë 18.06.2020, komisionere S. Zh. kishte paraqitur përpara trupit gjykues që po shqyrtonte çështjen e rivlerësimit të z. Alaudin Malaj, një kërkesë për heqje dorë nga procesi i rivlerësimit për këtë subjekt, kërkesë kjo e bazuar në nenin 27, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**20.7** Referuar akteve bashkëlidhur kërkesës së komisioneres S. Zh., rezultoi që më datë 03.06.2020, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ishte depozituar nga z. I. Zh. (bashkëshorti i znj. S. Zh.) një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Alaudin Malaj nga gjykimi i çështjes penale në ngarkim të tij me nr. akti {\*\*\*}, fakt për të cilin, sipas pretendimit të tij në kërkesë, kishte ardhur në dijeni më datë 01.06.2020, nga të dhënat e fletëthirrjes. Sipas z. I. Zh., kërkesa e tij për përjashtimin e z. Alaudin Malaj lidhej me faktin që ky gjyqtar ishte në proces rivlerësimi kalimtar dhe në përbërje të trupit gjykues që do të rivlerësonte këtë subjekt ishte dhe bashkëshortja e tij, znj. S. Zh..

**20.8** Trupi gjykues i ngritur me short sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2020, “Për ngritjen e trupit gjykues që do të marrë në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisioneres S. Zh. nga procesi i rivlerësimit për subjektin Alaudin Malaj”, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.06.2020, vendosi t’i kërkojë Gjykatës së Apelit Tiranë informacion lidhur me çështjen gjyqësore të sipërcituar, ku subjekti i rivlerësimit paraqitet në cilësinë e gjyqtarit relator. Në vijim të komunikimeve me kryetarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, trupi gjykues mori dijeni të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë, me anë të të cilit ishte vendosur pranimi i kërkesës së z. I. Zh. për përjashtimin e gjyqtarit (relator) Alaudin Malaj nga shqyrtimi i çështjes penale nr. {\*\*\*}, datë regjistrimi 10.10.2017.

**20.9** Në vijim të këtij komunikimi, trupi gjykues i caktuar me short për shqyrtimin e kërkesës së komisioneres S. Zh. për heqje dorë nga rivlerësimi i subjektit Alaudin Malaj, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2020, vendosi mospranimin e kërkesës së komisioneres S. Zh., me arsyetimin se objekti i kërkesës së saj tashmë kishte rënë.

**20.10** Në vlerësim të fakteve të parashtruara më sipër, trupi gjykues çmon se nga kontrolli i procedurave të kryera në Komision në drejtim të vlerësimit të kërkesës për heqje dorë nga ana e komisioneres S. Zh. nga çështja e rivlerësimit të subjektit Alaudin Malaj, nuk u vunë re parregullsi të karakterit procedural. Kërkesa u mor në shqyrtim nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short, në përputhje me parashikimet e nenit 27, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe vendimmarrja e këtij të fundit për mospranimin e kërkesës, pasi objekti për të cilin kishte nisur kjo procedurë ishte bërë i pamundur, gjendet e drejtë dhe e bazuar në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, komisionere S. Zh., në kuadër të parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, nga ky moment nuk kishte asnjë pengesë ligjore për të qenë pjesë e trupit gjykues që po kryente procesin e rivlerësimit të subjektit Alaudin



Malaj. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se komisionere S. Zh. nuk ishte në kushtet e pengesës ligjore për të vlerësuar efektet që do të passillte në ecurinë e procesit të rivlerësimit vendimi i KLGj-së nr. {\*\*\*}, datë 30.07.2020, për mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin Alaudin Malaj për shkak të dorëheqjes së tij nga detyra, çka përbën dhe thelbin e vendimit të Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, objekt kontrolli referuar ankimit të subjektit të rivlerësimit.

**20.11** Sa i takon pohimit të subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore publike para Kolegjit në datën 11.01.2020, se ai ka bërë kërkesë për përjashtimin e komisioneres S. Zh. dhe pretendimit se lidhur me këtë kërkesë nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Komisioni, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të administruar nga Komisioni, e gjen këtë pohim dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër, të pabazuar në aktet procedurale të administruara në fashikullin e Komisionit.

**20.12** Sa i takon pretendimit të subjektit se në përbërje të trupave gjykuese që kanë marrë vendim lidhur me kërkesat për dorëheqje dhe/apo përjashtim të komisionerëve O. K. dhe L. H., sipas rastit, ka qenë edhe komisionere F. Sh. e cila, sipas subjektit të rivlerësimit, ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, për shkak se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ishte në lidhje farefisnore (vajzë xhaxhai) me komisioneren F. Sh., trupi gjykues e gjen këtë pretendim të pambështetur në ligj. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mban në konsideratë parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative, sipas të cilave, referuar marrëdhënies së deklaruar, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk përfshihet në rrethin e personave të cilët konsiderohen të afërm të shkallës së dytë<sup>4</sup> me anëtarin e organit vendimmarrës, në rastin konkret komisioneren F. Sh., që të mund të vendoste këtë të fundit në kushtet e pengesës ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 30, shkronja “b” e këtij Kodi, për të marrë pjesë në përbërje të trupave gjykuese lidhur me shqyrtimin e kërkesave për heqje dorë dhe përjashtim të komisionerëve O. K. dhe L. H.. Për rrjedhojë, vlefshmëria e çdo vendimmarrjeje që lidhet me çështjen e rivlerësimit të subjektit Alaudin Malaj, që rrjedh si pasojë e vendimmarrjeve të trupave gjykuese në përbërje të të cilave ka qenë komisionere F. Sh., nuk është e cënueshme në drejtim të pretendimeve për shkelje të parimit të paanshmërisë në vendimmarrje.

**20.13** Sa u takon pretendimeve të subjektit për (i) shkelje të të drejtave të tij në drejtim të mosdhënies së kohës së nevojshme për paraqitjen e provave në mbrojtje të interesave të tij të ligjshëm në kuadër të procedurës së rivlerësimit të zhvilluar ndaj tij; dhe (ii) moskryerjen e veprimeve hetimore pas ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues, si pasojë e zëvendësimit të komisionerit L. H. me komisionerin R. I.; si dhe (iii) diskriminim nga ana e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, trupi gjykues çmoi të mbajë në konsideratë se këto pretendime, në rastin objekt gjykimi, i referohen sjelljes së Komisionit në drejtim të procedurave për kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe jo të vendimmarrjes konkrete të trupit gjykues të çështjes, e cila konsiston në ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si pasojë e dorëheqjes nga detyra të vetë subjektit të

<sup>4</sup>Për më tepër, shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 219, datë 28.03.2013, paragrafi 17, në veçanti nënparagrafi 17.2 “e”:

[http://gjykataelarte.gov.al/gjl\\_ceshtje\\_detaje.php?caseId\\_sel=2008-028&ln=Lng1&uni=20210414184303134059357582575366](http://gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=2008-028&ln=Lng1&uni=20210414184303134059357582575366)

rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se çdo parregullsi potenciale në drejtim të zhvillimit të procedurës së rivlerësimit, e cila kishte për qëllim rivlerësimin e subjektit Alaudin Malaj, nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e thelbit të vendimmarrjes së kundërshtuar të Komisionit, e cila lidhet me ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si pasojë e humbjes së statusit të subjektit të rivlerësimit *ex officio*, në kuptim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak të dorëheqjes së tij nga detyra.

21. *Lidhur me kundërshtimin nëpërmjet ankimit, në mënyrë të posaçme edhe të vendimit të ndërmjetëm të Komisionit të datës 15.04.2020, për mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres E. Ç., pasi sipas tij trupi gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e tij ka parashtruar në vendim disa fakte të pavërteta, si dhe se subjektit të rivlerësimit nuk i është vënë në dispozicion një kopje e njësuar e praktikës së ndjekur nga Komisioni për këtë vendimmarrje, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, kërkoi nga Komisioni përcjelljen e fashikullit të plotë të çështjes të administruar gjatë procesit të rivlerësimit dhe garantoj vënien në dispozicion të subjektit të rivlerësimit dhe njohjen e tij me aktet e fashikullit, duke vlerësuar të korrigjuar, për pasojë, në kuptim të parashikimeve të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, çdo gabim procedural të Komisionit në drejtim të garantimit të së drejtës së subjektit për mbrojtje efektive të interesave të tij të ligjshëm para Kolegjit, në lidhje me shkaqet e ngritura në ankim.*
22. Trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me shqyrtimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e komisioneres E. Ç. nga përbërja e trupit gjykues të Komisionit që do të kryente rivlerësimin e ankuesit, si dhe pasi kontrolloi procedurat e ndjekura nga Komisioni në drejtim të sa më sipër, konstatoi se nuk rezultuan shkelje të natyrës procedurale në shqyrtimin e kësaj kërkesë të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në drejtim të bazueshmërisë së vendimit të Komisionit të datës 15.04.2020, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres E. Ç., trupi gjykues arriti në konkluzionin se ky vendim është i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj, pasi nuk rezultoi e provuar ekzistenca e ndonjë prej rasteve të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi, të cilat do ta vendosnin komisioneren E. Ç. në situatën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit Alaudin Malaj.
23. Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit nr. 294, datë 15.09.2020, nuk është i cenusshëm në drejtim të shkeljeve procedurale të pretenduara lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Gjithashtu, nuk u konstatuan as shkelje të tjera procedurale me ndikim në vlefshmërinë e këtij vendimi përfundimtar të Komisionit.
24. Sa i takon kërkimit të parashtruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, për prishjen e vendimit të Komisionit lidhur me ndalimin e pikës 2 të dispozitivit të tij<sup>5</sup>, me pretendimin se ky ndalim bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar në ligj, për sa kohë ndalimi i përcaktuar nga Komisioni është rrjedhojë e zbatimit të drejtpërdrejtë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>5</sup> Shih paragrafin 4 më sipër në vendim.

25. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni dhe gjykimit në Kolegj, rezultoi e provuar se, me vendimin nr. 265, datë 30.07.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Alaudin Malaj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit Alaudin Malaj, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status, me efekt nga data 31.07.2020, dhe se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit pranë gjykatës kompetente. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Alaudin Malaj dhe zbatimin e pasojës juridike të parashikuar nga pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është i drejtë dhe i bazuar në parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 294, datë 15.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Alaudin Malaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 23.02.2021, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*